



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:184751
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05739424

PA1.nr.1533/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Visar Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.A nga Prishtina, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit G.A të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.2963/23, i datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit G.A, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2963/23, i datës 28.09.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.2693/23, i datës 29.09.2023, të akuzuarin G.A e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 400 € (katërqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për

çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim. Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 i KPRK-ës nga i akuzuari konfiskohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë prej 0.61+/- 0.0001 gram. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo substancë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi. Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet euro) dhe shumë prej 20 (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

I pandehuri G.A, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar t’ua ndryshoj dhe të akuzuarit t’i shqiptoi një dënim më të butë apo të njëjtin ta anuloj dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1567/23 të datës 05.12.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit G.A, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

I akuzuarit G.A e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, ku pretendon se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim të plotë me arsyetimin, se nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejte dhe duhur të gjitha rrethanat lehtësuese që ndikojnë në lartësinë e dënimit, megjithëse konsiderojmë se për këtë ka pas hapësirë. Gjykata Themelore në Prishtinë — Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e saj, në frymën e Institutit mbi Pranimin e Fajësisë, ka mbivlerësuar rrethanat rënduese, e nga ana tjetër rrethanat lehtësuese konsiderojmë se është dashur ti vlerësojë në mënyrë më të drejtë, sepse përcaktojnë zbutjen e dënimit në ngarkim te pandehurit Genc Arifaj. Pendimi i thellë dhe i sinqerte nga ana e të akuzuarit, kjo rrethanë ka lidhje me sjelljen e personit pasi ka kryer veprën penale dhe që me pendimin e thellë ka treguar qartë se në të ardhmen nuk do ta përsëris veprën penale te ngjashme apo të tjera dhe se do të ndërrojë sjelljen e bëhet i dobishëm për shoqërinë. Ne kuptim të nenit 70 të Kodit Penal të Kosovës në par.3 cek: ”Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme lehtësuese, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, moshën e personit të dënuar, i ri apo i moshuar, bashkëpunimi vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale, pranimi i fajit, andaj, e konsiderojmë se në bazë të nenit 70, paragrafi 3, nen par 3.3, 3.6, 3.9, 3.10, 3.11 dhe 3.12 të KPRK-së, gjykata ka qenë e obliguar që t’i marrë si rrethana lehtësuese rrethanat e lartcekura dhe për të dënuarin të

caktojë një dënim sa më të ulët, i cili do t'i kishte shërbyer qëllimit të dënimit, pasi që i pandehuri ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, keqardhje e cila dëshmohet nga pranimi i menjëhershëm i fajësisë për te veprën penale për te cilën është akuzuar. Pendimi i thellë dhe i sinqertë nga ana e të akuzuarit është një rrethanë e cila ka lidhje të ngushtë me sjelljen e personit pasi ka kryer veprën penale dhe që me pendimin e thellë i pandehuri ka treguar qartë se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale të ngjashme apo vepra të tjera. Qëllimi i Institutit të Pranimi të Fajësisë favorizon një zgjidhje më fleksibile në këtë çështje penale dhe mendojmë se gjykata e shkallës së parë ka pasur mundësi që te zbatoje institutin e zbutjes së dënimit në minimumin e parapare ligjor. Pas shqyrtimit të gjitha rrethanave lehtësuese të lartcekura në ankesë, konsiderojmë se një dënim i shqiptuar më i butë nga ana e gjykatës do të arrinte mjaftueshëm qëllimin e dënimit, i parashikuar në dispozitat ligjore, nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të akuzuarit, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit vetëm më gjobë dhe jo dënim me kusht, për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana posaçërisht lehtësuese ndaj të pandehurit gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, ka bashkëpunuar me prokurorin, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e veprës penale dhe se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryejë vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, si dhe faktin se i akuzuari edhe më parë kaq enë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më i butë. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1533/23, më datë 23.05.2024

Procesmbajtës,
Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Ferit Osmani
